

## PASDARKA E MADHE

*Kjo Shërbesë këndohet mbrëmë, në periudën e Kreshmëve të Mëdha, të Hënave, të Martave, të Mërkurave, dhe të Enjteve gjer të Martën e Madhe. Passi bekon Prifti, thuhet Trishenti, pastaj:*

## PSALMI 4

Dëgjo-më kur të thërres o Perëndi i drejtësisë; jam në shtrëngicë të madhe; kij mëshirë për mua dhe dëgjoje lutjen time. O bij të njerësve, gjer kur do ta hithni lavdinë time në baltë? Gjer kur do të doni madhështi dhe grabitje? Mësoni se Zoti e ka shënuar besimin për veten e tij, se Zoti do më dëgjonjë kur ta thërres. Ruaju dhe mos mëkato; këshillohu me zëmëren tënde natën edhe rri urtë; blato therore drejtësie, dhe kij besim më Zotin. Shumë thonë se kush munt të na bënjë nonjë të mirë? O Zot, tregoje dritën e fytyrës sate mi ne, se ti na ke gëzuar zëmëren më tepër se atyre

kur u shtohet gruri dhe vera. Pra, do të bie dhe do të fle i qetë, se ti, o Zot, më ruan e më shiguron.

### PSALMI 6

O Zot, mos më qërto në zëmërimin tënt, edhe mos më mundo në mërinë tënde. Kij mëshirë për mua, o Zot, se jam i pafuqishim; shëro-më, o Zot, se më janë thyer eshtrat. Shpirti im u-trubullua keq; po ti, o Zot, gjer kur? Këthehu o Zot çliro-ma shpirtin, dhe shpëto-më pas mëshirës sate. Se kush do të kujtonjë pas vdekjes, dhe kush do të lavdëronjë në varr? Jam lodhur nga psherëtimet, se tërë natën e shkonj me qarje, dhe shtrati im është i mbytur nga lotet. Syri im u-shua prej hidhërimit, se më kanë mplakur armiqtë. Largohuni prej meje, ju, që vepëroni padrejtësi, se Zoti e dëgjoj qarjen time; Zoti e priti faljen time. U-turpërofshin dhe u-shofshin gjithë armiqtë e mi; u-kthefshin prapa me faqe të zezë përnjëheresh.

### PSALMI 13

Gjer kur do më harrosh, o Zot? Apo për gjithënjë? Gjer kur do ta fshehësh faqen prej meje? Gjer kur do të këshillohem me shpirtin dhe me zëmren e helmuar për ditë? Gjer kur do të lartësohet armiku im përmi mua? Vër-më re, dhe dëgjo-më, o Zot, o Perëndia im. Ndrin-mi sytë, që të mos fle gjumin e vdekjes, që të mos thotë armiku, që është më i fortë se unë, dhe të mos gëzohen ata, që më ndjekin, kur të tronditem. Se unë shpëreva nga mëshira jote; dhe zëmra do më gëzohet nga shpëtimi yt; edhe do ta këndonj Zotin për të mirat, që më ka bërë. Vër-më re, dhe dëgjo-më, o Zot, o Perëndia im. Ndrin-mi sytë, që të mos fle gjumin

e vdekjes, që të mos thotë armiku, që është më i fortë se unë.

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shënjtë. Tani dhe përherë dhe në jetë të jetëve. Amin. Alilluia, alilluia, alilluia. Mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot. Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë. Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve. Amin.

Zonjë Hyj lindëse e tërëshenjtë, nërmjeto për ne dhe çdo mëkatar.

Engjëj dhe Krye-ëngjëj të Shenjtë, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

Apostuj dhe Profetë, Dëshmorë dhe Shenjtorë, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

Atër Oshënarë, Barinj dhe Mësonjës, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

O fuqi e pamundur, e Kryqit të çëmuar, nërmjeto për ne dhe çdo mëkatar.

O Perëndi, kij mëshirë për ne dhe çdo mëkatar.

O Zot, mëshirona.

### PSALMI 25

Tek ti, o Zot, e ngre shpirtin; ty të kam besim, o Perëndia im. Mos ma nxi faqen, mos e lër armikun të dalë faqebardhë. Mos i turpëro ata, që të shërbejnë; po turpëroji ata, që të kundrështojnë më kot. Trego-më udhët e tua, o Zot; mëso-më patekat e tua. Prir-më tek e vërteta jote, dhe mëso-më, se ti je Perëndia i shpëtimit tim, se ty të shërbenj tërë ditën. Kujtoji dhëmpshëritë dhe mëshirat e tua të vjetra, o Zot; edhe mos i kujto paudhësitë dhe mëkatat e djalërisë. Kujto-

më, o Zot, pas mëshirës dhe pas mirësisë sate. Zoti është i mirë dhe i drejtë, përandaj do tua mësonjë udhën mëkatarëve. Do t'i udhëheqë të butët në gjyqin, edhe do tua mësonjë udhën të butëve. Të gjitha patekat e Zotit i shpien në mëshirën dhe në të vërtetën ata, që ia ruajnë dhjatën dhe dëshmimet. Për emrin tënt, o Zot, fal-mi paudhësitë, se janë shumë të mëdha. Cili është ay njeri, që ia ka frikën Zotit? Ati do tja tregonjë udhën, që duhet të zgjedhë. Shpirti i tij do ta fitonjë paqen, dhe fara e tij do ta trashëgonjë dhenë. Zoti është forca e atyre, që ia kanë frikën, dhe atyre do tua tregonjë dhjatën. I kam sytë kurdoherë nga Zoti, se ay do m'i nxjerë këmbët nga kurthi. Shtjer-ma syrin, dhe mëshiro-më, se jam i shkretuar dhe i helmuar. Hidhërimet e zëmrës më janë rritur, po ti nxir-më nga shtrëngicat. Shiko-m'a dhëmbjen dhe hidhërimin, dhe fal-mi të gjitha mëkatat. Shikoji armiqtë e mi, se janë të shumë; dhe më urrejnë egërsisht. Ruaj-ma shpirtin, dhe çliro-më; mos ma nxi faqen, se më ty shpëreva. Shpëto-më, se të kam shërbyer me drejtësi dhe zëmërbardhësi. Çpërbleje Israelin, o Zot, prej gjithë hidhëtimeve.

### PSALMI 31

Më ty shpëreva, o Zot; mos u-turpërofsha kurrë; shpëto-më pas drejtësisë sate. Vërma veshin, shpëto-më për së shpejti. Bëhu shkëmbi dhe fortesa ime dhe kështjella ime, dhe trego-ma udhën për emrin tënt. Nxir-më nga kurthi, që më kanë kurdisur, se ti je mprojtësi im, o Zot. Ty ta dorëzonj shpirtin, se ti më çpërbleve, o Zot, o Perëndi i vërtetë. I kam urryer gënjeshtarët, edhe kam shpëryer më Zotin. Do të gë-

zohem dhe do të ngazëllohem për mëshirën tënde; se ti u-kujdese për hidhërimet e mia; dhe ti ma shpëtove shpirtin nga shtrëngicat; edhe nukë më mbylle në dorën e armikut, po m'i çlirove këmbët në fushën e gjërë. Mëshiro-më, o Zot, se jam në shtrëngicë; syri, dhe shpirti, dhe trupi më janë fishkur prej hidhërimit. Se e kam shkuar jetën në helme dhe psherëtime; se forca m' u-venit, edhe eshtrat m' u-këputnë nga paudhësia. U-bëra gazi i armiqve dhe i fqinjve, dhe tmerri i miqve dhe të njohurve, të cilët iknin, kur më shikonin. Më kanë harruar si një njeri të vdekur; më kanë hedhur si një enë të thyer; më kanë përqeshur reth e rotull; janë këshilluar të ma marrin shpirtin. Po unë shpëreva më ty, o Zot, edhe thashë: Ti je Perëndia im. Jeta ime është në dorën tënde. Çliro-më prej armiqve, që më ndjekin. Ndrin-më dhe shpëto-më pas mëshirës sate, se unë jam shërbëtori yt. Mos më turpëro o Zot, se ty të kam thirrur, turpëroji të pabesët, edhe çporri në greminë. Mbyll-u gojën gënjeshtarëve përpara të drejtëve me madhështi dhe përbuzje. Se mirësia jote, o Zot, është e madhe për ata, që ta kanë frikën. Ke bërë çudira përpara faqes së njerësve për ata, që shpërejnë më ty. Do t'i mprosh me faqen tënde nga goditjet e armiqve. Do t'i ruash me tendë nga helmi i gjuhëve të tyre. I bekuar është Zoti, se më ka treguar mirësinë e çudiçime në qytet të fortë. Se në nxitim e sipër, kam thënë, që ma hoqe syrin, po ti ma dëgjove lutjen, kur të thirra. Dojeni Zotin, ju oshënarët e tij, se Zoti i ruan besnikët, edhe i çpagan madhështorët. Kini kurajë, se ay do tjuaj forconjë zëmrën të gjithëve, që shpëreni më Zotin.

## PSALMI 91

Ay, që banon në shtëpinë e të Lartit, do të rronjë nënë hien e Fuqimadhit. Do t'i them Zotit: "Ti je përikja ime dhe kështjella ime," dhe ati do t'i kem besim. Se ay do të shpëtonjë nga kurthi i gjahtarit edhe nga murtaja e zezë. Ay do të mbulonjë me pëndët e tij, dhe do të fshihesh nënë fletët e tij, se e vërteta e tij është shqyt edhe mburonjë. Ahere nukë do të kesh frikë nga tmerri i natës as nga shigjeta që fluturon ditën, as nga murtaja që ecën në errësirë, as nga rëmuja që shkreteton më drekë. Një mijë do të bien më të mëngjër, dhe dhjetë mijë më të djathtë, po ty nuk do të afrohet askush. Vetëm do të vësh re, dhe do ta shikosh me sy çpagimin e të paudhëve. Se Zoti është përikja jote dhe banesa jote; dhe asnjë e keqe nukë do të afrohet; edhe vrushlulla nukë do të vinjë pranë banesës sate; se do t'i porrositë Engjëjtë e tij të të ruajnë në gjithë udhët e tua. Do të ngrenë mi duartë, që të mos përpjekësh këmbët mi gurët. Do të bareç mi gjërpërinj edhe mi nëpërka, dhe do të shkelësh me këmbë luanë dhe drangonj. Se shtive dashuri më Zotin, dhe ay do të çlironjë, dhe do të lartësonjë, se e ke njohur emrin e tij. Do ta thërreç, edhe do të dëgjonjë, do të përkrahë në shtrëngicë, do të shpëtonjë, dhe do të lavdëronjë. Do të gëzonjë me ditë të gjata, dhe do të tregonjë shpëtimin e tij.

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

Alilluia, alilluia, alilluia.

Mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot.

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë; tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

*Pastaj këndohen Vargjet pasonjëse më T. T. II, dyke shtuar në funt si refren: "Zoti është bashkë me ne."*

*Zoti është bashkë me ne. Dijeni o kombe që jini të mundur.*

*Dëgjojeni anëmbanë dheut.*

*O të fortë do të mundeni.*

*Sado të forcoheni, prapë jini të mundur.*

*Zoti do t'i çkatërronjë këshillat tuaja.*

*Fjala që do të lithni, nukë do të qëndronjë.*

*Nukë trëmbemi as tronditemi nga ju.*

*Do të bekojmë Zotin, Perëndinë tonë, dhe do tja kemi frikën.*

*Do t'i kemi besim, se ay na shenjtëron.*

*Do t'i kemi besim, se ay na shpëton.*

*Ja unë edhe djemat që më dha Perëndia.*

*Populli që bariste n' errësirë, pa një dritë të madhe.*

*Ju rrini nënë hien e vdekjes, po drita shkëlqen përmë ne.*

*Se një djalë na lindi, dhe një Bir na u-dha.*

*Dhe ay do ta marrë qeverimin përsipër.*

*Edhe paqja e tij nukë do të ketë kufi.*

*Edhe do të quhet emr' i tij, Engjëll i Këshillës së Madhe.*

*Këshilltar i çudiçim.*

*Perëndia i fuqishim, Kryetar, Princ i Paqes.*

*Ati i jetës së pritme.*

*Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.*

*Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.*

*Zoti është bashkë me ne, Dijeni o kombe që jini të mundur.*

*Pastaj këndohen pa zë Troparet pasonjëse:*

Si shkova ditën, të përhironj o Zot; të lutem fal-më, mbrëmën dhe natën të pamëkatme, o Shpëtimtar dhe shpëto-më.

LAVDI. Si shkova ditën, të lavdëronj o Zot; të lutem fal-më, mbrëmën dhe natën pa skandal, o Shpëtimtar dhe shpëto-më.

TANI. Si shkova ditën, të përhymnonj o i Shenjtë; të lutem fal-më, mbrëmën dhe natën pa lakmim, o Shpëtimtar dhe shpëto-më.

*Pastaj Vallja e Dytë nis më Tingëllin IV:*

Me trumbeta kiple çdo Kerubim, të këndon plot me bujë dhe lavdërim.

Dhe me gjashtë krahë çdo Serafim, të hymnon pa pushuar me ngazëllim.

Engjëjtë ne qiellin shekullor, t' adhurojnë me Psalm edhe Trishenjtor.

Ishe që prej jetësh o At' e je, Bir të vetëm pa nisje Jesunë ke.

Shpirt' i Shenjtë ka gjithatë lavdi, të pandarë të tre bëjnë një Trini.

Zonja Virgjëreshë o Shën Mari, lindi Krishtin njeri edhe Perëndi.

Atër dhe Shenjtorë plot me lavdi, që fituat Parajsë dhe lumëri.

Bëni nërmjetime për çdo besnik, të shpëtojme nga djalli dhe Ferr' i lik.

Ja ku po ju lutemi pa pushim, Trishenjtorin këndojmë me mallëngjim.

*Pastaj këndohet me zë të unjur Simboli i Besës, dhe këndohen Vargjet pasonjëse në T. IV, dyke nisur Vallja e Dytë:*

Zonjë Hylindëse e tërëshenjtë, nërmjeto për ne dhe çdo mëkatar.

Zonjë Hyjlindëse e tërëshenjtë, nërmjeto për ne dhe çdo mëkatar.

Zonjë Hyjlindëse e tërëshenjtë, nërmjeto për ne dhe çdo mëkatar.

Engjëj dhe Krye-ëngjëj të Shenjtë, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

Engjëj dhe Krye-ëngjëj të Shenjtë, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

Apostuj dhe Profetë, Dëshmorë dhe Shenjtorë, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

Apostuj dhe Profetë, Dëshmorë dhe Shenjtorë, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

Atër Oshënarë, Barinj dhe Mësonjës, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

Atër Oshënarë, Barinj dhe Mësonjës, nërmjetoni për ne dhe çdo mëkatar.

O fuqi e pamundur, e Kryqit të çëmuar, nërmjeto për ne dhe çdo mëkatar.

O fuqi e pamundur, e Kryqit të çëmuar, nërmjeto për ne dhe çdo mëkatar.

O Perëndi, kij mëshirë për ne dhe çdo mëkatar.

O Perëndi, kij mëshirë për ne dhe çdo mëkatar.

O Zot, mëshirona.

*Pastaj Trishenjti, dhe këndohen pa zë Troparet pasonjëse më T.II:*

Ndrit-mi sytë, o Krisht Perëndi, që të mos fle gjumin e vdekjes, që të mos thotë armiku, që është më i fortë se unë.

LAVDI. Forco-ma shpirtin o Perëndi, se shkonj nëpër shumë gracka; ruaj-më prej atyre si i mirë, dhe shpëto-më si njeridashës.

TANI. Meqënëqë s' kuxojmë nga mëkatat e shuma, nërmjeto për ne pranë Birit tënt, o Virgjëreshë Hyjlindëse, se lutja e Nënës ka fuqi të madhe pranë Zotit. Mos i përbuz mëkatarët o e mire, se Zoti është mëshirëplot, edhe do të na shpëtonjë, se dignoj të pësonjë për ne.

KENDONJESI: Mëshiro, o Zot (40 herë).

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

Ti je e nderuar mi Kerubim, dhe e lavdëruar pa përqsaje mi Serafim, ti me të vërtetë linde Fjalë Perëndinë, pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

Mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot.

Beko, o Atë, më emrin e Zotit.

PRIFTI: Me uratat e Shën Atërve tanë, o Zoti ynë Jesu Krisht, mëshirona dhe shpëtona.

KORI: Amin.

DHJAKU: Le t'i lutemi Zotit.

#### URATA E SHEN BASILIT

PRIFTI: O Zot, o Zot, që na shpëtove nga të gjitha shigjetat, që na vërviten ditën, shpëtona edhe nga pusitë, që na përgjojnë natën. Prit-i ngritjet e duarve tona si fli të mbrëmës. Vlerësona të shkojmë edhe hopin e natës faqebardhë, pa nonjë ngasje të keqe, dhe shpëtona nga të gjitha trubullimet edhe flashkëritë, që rjedhin prej djallit. Fal-u shpirtëve tona pendim, edhe mëndjeve tona kujdes për nxonitjen e tmerruar dhe të drejtë të gjyqit të funtmë. Mberthen-

aji trupet me frikën tënde, dhe qetësoji miset tona të përmidheshme, që të gëzohemi edhe në gjumë me pamjen e gjykimeve të tua. Largoji prej nesh të gjitha imagjinatat e pahieshme, dhe dëshirat e dëmshime. Dhe ngrerna në kohën e faljes të forcuar në besë dhe të përparuar në porrosit' e tua; me mirëdashjen e Birit të vetëm, me të cilin je i bekuar, bashkë me Shpirtin e tërëshenjtë dhe të mirë dhe jetëbërës, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

KENDONJESI: Ejani t'i falemi dhe t'i përgjunjemi Krishtit, Perëndisë dhe Mbretit tonë. (3 herë)

*Pastaj këndohen Psallmet 51 dhe 102:*

#### PSALMI 102.

Dëgjo-ma lutjen, o Zot, edhe prit-ma thirrjen. Mos ma kthe faqen në ditën e hidhërimit. Vër-ma veshin, dhe dëgjo-më, kur të thërres. Se ditët më janë mbytur si tym, edhe eshtrat më janë djegur si prush. Zëmra m' u-sëmur, dhe m' u-tha si bari, edhe nukë më hahet buka. Jam bërë koskë dhe lëkurë nga psherëtimet. Jam bërë si pelikani i shkretëtirës, jam bërë si korbi i natës së zezë. Vigjëllonj si spurdhaku mi çatinë. Armiqtë më përqeshin tërë ditën, edhe të çmendurit përgjërohen kundër meje. Se kam ngrënë hi si bukë, dhe kam përzier ujën me lote nga zëmërimi dhe mëria jote, se më ngrite përpjetë, dhe më plase përdhe. Ditët më shkojnë si hie, dhe jam tharë si bari. Po ti, o Perëndi, do të mbetesh përherë, dhe do të kujtohesh bres pas brezi. Do të ngrihesh, dhe do të kesh mëshirë për Sionën, se arriu koha e favortë, që ke caktuar. Se shër-

bëtorët e tu kanë mall për gurët edhe për pluhërin e saj. Edhe paganët edhe mbretërit e botës do t'ja kenë frikën emrit tënt edhe lavdisë sate. Se Zoti do ta ndërtonjë Sionën dhe do të çfaqet me lavdi. Do ta dëgjonjë dhe do ta mbaronjë lutjen e të përbuzurit. Edhe kjo do të shkruhet për brezin e pritme, edhe brezat e pastajmë do ta lavdërojnë Zotin. Se e hodhi syrin nga lartësia e Shenjtërorës; se Zoti e shikoj dhenë nga qielli; dhe e dëgjoj psherëtimën e të burgosurve; dhe i çliroj të dënuarit për vdekje; që t'ja lëçitin emrin në Sion dhe ta lavdërojnë në Jerusalem, kur mbledhen popujtë dhe mbretërit që t'i shërbejnë Zotit. Ma preve fuqinë dhe m'i shkurtove ditët, edhe unë thashë: O Zot, mos më rëmbe në lulen e jetë sime. Vjetet e tua vazhdojnë bres pas brezi; ti e ke themeluar dhenë, ti e ke ndërtuar qiellin. Ato do të humbasin, po ti do të mbetesh. Të gjitha do të vjetërohen si roba, edhe do t'i ndrosh, edhe do t'i hedhësh; po ti do të mbetesh gjithay, edhe vjetet e tua nukë do të kenë funt. Edhe bijtë e shërbëtorëve të tu do të vazhdojnë, dhe fara e tyre do të qëndronjë përpara teje për jetë.

### LUTJA E MANASIUT

**PRIFTI:** O Zot i gjithëfuqishim, Perëndi i Atërve tanë, Abraham, Isaak, Jakob, edhe farës së tyre; që ke bërë qiellin e dhenë me tërë botën e tyre; që e ke lidhur detin me urdhërin tënt; që e mbylle avushën, dhe e shilove me emrin tënt; që trëmben dhe dridhen të gjithë nga fuqia jote; se madhështia e lavdisë sate nukë ka kufi; se zëmërimi yt kundër mëkatarëve nuk është

rëndë, dhe mëshira jote është e pamatur dhe e pagjyrmësuar; se ti je Zot i lartë, i dhëmpshur, zëmërgjerë, mëshirëplot, edhe i butë për ligësitë e njerësve; se ti u premtove ndjesë mëkatarëve pas mirësisë sate; se ti u fale pendimin mëkatarëve për shpëtimin e tyre; edhe këtë pendim nuk e fale për të drejtët, për Abrahamin, Isaakun dhe Jakobin, të cilët nukë mëkatuan përpara teje, po për mua mëkatarin, që kam bërë më tepër mëkata se rëra e detit. Janë rritur paudhësitë e mia, o Zot, janë rritur paudhësitë e mia, dhe nukë jam i vyer t'i ngre sytë dhe ta shoh lartësirën e qiellit; jam krusur prej paudhësive si prej një vargoj të rëndë prej hekuri; nukë kam prëhje, se ta ndeza zëmërimin; se e bëra të keqen përpara teje; se ta shkela dashurinë; se nuk i ruajta porrositë e tua. Po tani të përgjunjem me zëmër, dhe i lutem mirësisë sate: Mëkatova, o Zot; mëkatova, dhe i njoh paudhësitë e mia, dhe të lutem: Ndje-më, o Zot; fal-më, dhe mos më hump për tërë jetën sipas ligësive të mia, dhe mos më dëno në fundin e dheut më të përposhtme. Se ti je Perëndia im, Perëndia i atyre, që pendohen; dhe ti do më shpëtosh pas mëshirës sate, ndonëse jam i pavyer; dhe ty do të lavdëronj gjithë ditët e jetës sime.

Se ty të këndojnë gjithë forcat e qiellit, edhe jotja është lavdia në jetët e jetëve, Amin.

*Pastaj këndohet Trishenjtë dhe Troparet pasonjës pa zë:*

Mëshirona o Zot mëshirona, se jemi mëkatarë, dhe nukë kemi tjetër mprojtës. Pra të lutemi mëshirona.

**LAVDI.** Mëshirona o Zot, se nukë kemi tjetër shpresë; mos na i kujto paudhësitë, dhe mos u-zëmëro

me ne; po shtjer-na syrin si i dhëmpshur, dhe shpëtona nga armiqtë; se ti je Perëndia ynë, dhe ne jemi populli yt; ti na ke bërë me dorën tënde, dhe po thërresim emrin tënt.

TANI. Hap-na portën e mëshirës sate, o Hyjlindëse e bekuar, ti je shpresa jonë e vetëm, mos na lër të humbasim, po shpëtona nga reziket, se ti je shpëtimi i të Krishterëve.

KENDONJESI: Mëshiro, o Zot. (40 herë)

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin. Ti je e nderuar mi Kerubim, dhe e lavdëruar pa përjasje mi Serafim, ti me të vërtetë linde Fjalë Perëndinë, pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse. Mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot, mëshiro, o Zot. Beko, o Atë, më emrin e Zotit.

PRIFTI: Me uratat e Shën Atërve tanë, o Zoti ynë Jesu Krisht, mëshirona dhe shpëtona.

KORI: Amin.

DHJAKU: Le t'i lutemi Zotit.

PRIFTI: O Zot, o Perëndi, o At i gjithëfuqishim; o Zot, o Bir i vetëmlindur Jesu Krisht edhe Shpirti i Shenjtë, që jini një Hyni dhe një Fuqi, kini mëshirë për mua mëkatarin, dhe shpëtomëni mua, shërbëtorin e pavyer, nga dënimet e gjyqit të funtmë. Se i bekuar je në jetët e jetëve, Amin.

KENDONJESI: Ejani t'i falemi dhe t'i përgjunjemi Krishtit, Perëndisë, dhe Mbretit tonë të pavdekur. (3 herë)

### PSALMI 70

O Perëndi, eja dhe shpëto-më; eja dhe ndih-më, o Zot. U-turpërofshin dhe u-shofshin ata, që ma kërkojnë shpirtin; u-thefshin dhe u-çkatërrofshin ata, që më përqeshin. U-gëzofshin dhe u-ngazëllofshin të gjithë ata, që të kërkojnë, dhe të lavdërofshin për jetë ata, që duan shpëtimin tënt. Po unë jam i varfër dhe nevojar; eja dhe shpëto-më, o Perëndi; se ti je ndihmësi dhe çlironjësi im; o Zot, eja shpejt edhe mos u-vono.

### PSALMI 143

O Zot, dëgjo-ma faljen, vër-u veshin lutjeve të mia. Përgjeq-m'u pas mirësisë dhe pas drejtësisë sate, dhe mos hyr në gjyq me shërbëtorin tënt, se asnjë njeri i gjallë nukë munt të dalë i drejtë përpara teje. Se armiku ma ndoqi shpirtin; ma shtypi jetën përdhe; më varrosi në errësirë si të vdekur që prej kohe. Përandaj më është këputur shpirti, dhe më është dëshpëruar zëmra. Kujtonj ditët e lashta, mejtonj gjithë veprat e tua. I ndeh duartë përpara teje, shpirti im ka etje për ty posi dheu i thatë. Përgjeq-m'u shpejt, o Zot, se m' u-zu fryma, mos e këthe mënjane faqen tënde prej meje, se jam bërë si ata, që hidhen në gropë. Bëj-më ta shoh mëshirën tënde në mëngjes, se më ty kam shpresë, bëj-më të njoh udhën ku duhet të ecënj, se më ty e kam varrur shpirtin. Çliro-më prej armiqtë të mi, o Zot, se pranë teje vinj të fshihem; mëso-më të bënj dëshirën tënde, se ti je Perëndia im: trego-ma udhën e drejtësisë, se ti je zëmërmirë. Ngjall-më, o Zot, për emrin tënt; edhe pas drejtësisë sate nxir-ma shpirtin nga trubullimet; edhe pas mëshirës sate shtyp-i armiqtë e mi, dhe shuaj-i



gjithë ata që ma shtrëngojnë shpirtin, se unë jam shërbëtori yt. Dëgjo-më, o Zot, pas drejtësisë sate, edhe mos hyr në gjyq me shërbëtorin tënt; trego-ma udhën e drejtësisë, se ti je zëmërmirë.

*Pastaj Doksollogjia e Madhe pa zë, Trishenjtë, dhe këndohet me Vargjet pasonjës në Tingëllin Tërthor II:*

### KIRIE TON DHINAMEON

Zot i Math i poterave, eja tok me ne; ndihmës tjetër s' kemi, në shtrëngim të zëmrave të thyera. Zot i math i poterave, mëshirë kij për ne.

### VARGJET

*Lavdërojeni Perëndinë me Shenjtorët e tij; lavdërojeni për shigurinë e fuqisë së tij.*

*Lavdërojeni për poterat e tij; lavdërojeni për shkëlqimin e madhërisë së tij.*

*Lavdërojeni me trumbetë; lavdërojeni me këngëtore dhe me gitare.*

*Lavdërojeni me timpane dhe me valle; lavdërojeni me kordha dhe me strumenta.*

*Lavdërojeni me kimbale tingëllonjëse; lavdërojeni me kimbale brohoritëse.*

*Çdo frymë le ta lavdëronjë Zotin.*

*Lavdërojeni Perëndinë me Shenjtorët e tij.*

*Lavdërojeni për shigurimin e fuqisë së tij.*

Zot i math i poterave, eja tok me ne; ndihmës tjetër s' kemi, në shtrëngim të zëmrave të thyera. Zot i Math, i poterave, mëshirë kij për ne.

LAVDI. Sikur të mos kishim nërmjetarë, Shenjtorët pranë teje o Zot, si do të kuxonim të të hymnonim ty, o Shpëtimtar që të bekojnë Engjëjtë pa pushuar: Kursenaji shpirtet o zëmërnjohës.

TANI. Kam shumë faje o Hyjlindëse, dhe përkënj pranë teje, dhe të lutem shpëto-më. Vizito-ma shpirtin e sëmurë, dhe nërmjeto pranë Birit tënt, të më falë ndjesën e mëkatave, o e vetëm e bekuar.

Hyjlindëse e tërëshenjtë, mos më neverit për tërë jetën; mos më lër në mprojtje njerëzore, po ti vetë përkrah-më dhe mëshiro-më.

Çdo shpresë më ty e varr, o Zonjë Hyjlindëse, Nën' e Zotit Krisht, ti më ruaj përherë ti më mpro.

Mëshiro, o Zot. (40 herë).

DHJAKU: Le t'i lutemi Zotit.

PRIFTI: O Krisht, o Perëndi, që adhurohesh, edhe lavdërohesh më çdo kohë dhe më çdo orë në qjell edhe mi dhe, zëmërgjerë, zëmërdhëmpshur, dhe mëshirëplot, që i do të drejtët, edhe i mëshiron mëkatarët, që i fton të shpëtojnë me zotimin e të mirave të pritme; Ti, o Zot, pritnaji lutjet këtë orë, dhe drejtonaje jetën pas porrosive të tua. Shenjtëronaji shpirtet; paqësonaji trupet; ndreqnaji mejtimet; qëronaji zëmërat; edhe shpëtona nga të gjitha hidhërimet, reziket, edhe vojttjet. Mprona, ruajna, dhe udhëhiqna me anën e Engjëjve të Shenjtë, që ta arrijmë njësinë e besës dhe njohjen e lavdisë sate së paafëruar. Se i bekuar je në jetët e jetëve. Amin.

KENDONJESI: Mëshiro, o Zot. (40 herë.)

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

Ti je e nderuar mi Kerubim, dhe e lavdëruar pa përqsasje mi Serafim, ti me të vërtetë linde Fjalë Perëndinë, pra ty të madhështojmë, Zonjë Hyjlindëse.

Mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot.

Beko, o Atë, në emrin e Zotit.

PRIFTI: Perëndia na mëshiroftë, dhe na bekoftë, na tregoftë dritën e fytyrës së vetë, dhe na shpëtoftë.

KORI: Amin.

*Pastaj bëjnë tri metanira, dyke thënë një nga të tre Vargjet pasonjëse në çdo metani:*

I. Zot edhe Mjeshtër i jetës sime, mos më jep frymë përtese, kureshti, lavdidashjeje, dhe kotësie.

II. Po fal-më frymë urtësie, përunjësie, durimi, dhe dashurie.

III. Vlerëso-më, o Zot edhe Mbret, t'i shikonj fajet e mia, dhe të mos e gjykonj tim-vëlla.

Se i bekuar je në jetët e jetëve, Amin.

*Pastaj bëjnë dymbëdhjetë metanira të vogëla, dhe më në funt një të madhe me Vargun III. Pastaj këndohet Trishenjtë:*

KENDONJESI: Shenjt Perëndi, Shenjt i fuqishim, Shenjt i pavdekur, mëshirona (3 herë).

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve. Amin.

Trini e tërëshenjtë, mëshirona; o Zot, hirësoji

mëkatat tona; o Kryezot, fal-i paudhësitë tona; o i Shenjtë, vështroji dhe shëroji sëmudjet tona për emrin tënt.

Mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot.

Ati ynë që je në qjell, u-shenjtëroftë emri yt; arthtë mbretëria jote; u-bëftë dëshira jote si në qjell edhe mi dhe; bukën tonë të përdiçime epnaje neve sot; edhe falnaji fajet, sikundër edhe ne ua falim fajtorëve tanë; edhe mos na shtjer në ngasje, po shpëtona nga i ligu.

PRIFTI: Se jotja është mbretëria dhe fuqia dhe dhe lavdia, e Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

KORI: Amin.

KENDONJESI: Mëshiro, o Zot, (12 herë)

*Pastaj këndohen këto Urata:*

#### URATA E SHEN MARISE

*Prej Palit, Murgut të Manastirit të Evergjetit.*

KENDONJESI I. E papikluar, e papërlyer, a pacinuar, e panjollshime, Virgjëreshë e kulluar, Kryezonjë, nuse e Perëndisë, që bashkove Fjalën Perëndi me njerëzit me anën e lindjes sate së çudiçime, dhe ngrite në qjell natyrën e dënuar të gjindjes sonë; e vetëma shpresë e të dëshpëruarve dhe ndihma e të lëftuarve; përkrahja e gatishme e atyre, që përikin pranë teje; mos më përbuz mua mëkatarin dhe të mallkuarin, që e kam poshtëruar veten me dëshira, me fjalë dhe me vepra të shëmtuara, dhe jam bërë me dashje rob i dëfrimeve të jetës prej ngathësisë; po ti si Nënë e Perëndisë njeridashës, kij mëshirë për mua mëkatarin

dhe prodigun; dhe prit-ma lutjen, që të blatonj me buzë të përlyera; dhe nërmjeto si Nënë pranë Birit tënt edhe Zotit tonë që të ma hapë zëmrën njeridashëse me mirësi, dhe të më kthenjë në pendim, dhe të më tregonjë punëtor të mbaruar të porrosive të tij; dhe përkrah-më gjithenjë si mëshirëplote, simpathike, dhe mirëdashëse; mpro-më dhe ndih-më pa reshtur, thyeji sulmat e armiqve, dhe trego-ma udhën e shpëtimit në këtë jetë; dhe në ditën e vdekjes kujdes-u për shpirtin tim të mjerë, dhe largoji prej meje fytyrat e errëta të demonëve të paudhë; dhe në ditën e tmerruar të Gjyqit të funtmë shpëto-më nga Skëterra e zezë, dhe bëj-më trashëgimtar të lavdisë mistike të Birit tënt, edhe Perëndisë tonë. Për këtë vlerëso-më me nërmjetimin dhe përkrahjen tënde, o Kryezonja ime e përmishenjtë Hyjlindëse, me hirin dhe njeridashjen e Birit të vetëm, Zotit edhe Perëndisë dhe Shpëtimtarit tonë Jesu Krishtit. Ati i ka hie çdo lavdi, nder dhe adhurim, bashkë me Atin e panismë, dhe me Shpirtin e tërëshenjtë dhe të mirë dhe jetëbërës, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

#### URATA E KRISHTIT

*Prej Antiokut, Murgut të Pandektit*

KENDONJESI II: Dhe epna prëhjen e trupit edhe të Shpirtit neve, që po shkojmë për të fjetur, o Zot, edhe ruajna nga gjumi i mëkatit, dhe nga çdo voluptet i errët e natës. Pushonaji sulmat e pasioneve, shuaji shigjetat e zjarrta të djallit, që vërviten kundër nesh dinakërisht; përmbysnaji kryengritjet trupësore, dhe qetësonaji të gjitha dëshirat e përmidheshme dhe lëndore. Dhe dhurona, o Perëndi, mëndje vigjellonjëse,

gjykim të urtë, zëmër të kthjellët, gjumë të lehtë dhe pa nonjë fantasi satanike. Dhe zgjona në kohën e faljes, dhe forcona me porrositë e tua, dhe kujtona gjykimet e tua të patronditura. Vlerësona të të adhurojmë tërë natën, dhe të hymnojmë, dhe të bekojmë, dhe të lavdërojmë emrin tënt madhështor dhe të nderuar, të Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

KENDONJESI I: Virgjëreshë Hyjlindëse e bekuar dhe e përmilavdëruar, shpjer-ja lutjen tonë Birit tënt edhe Perëndisë tonë, dhe lyp-i të na shpëtonjë shpirtet me anën tënde.

KENDONJESI II: O Atë, shpresa ime; o Bir, përikja ime; o Shpirt i Shenjtë, fortesa ime; o Trini e Shenjtë, lavdi më ty.

KENDONJESI I: Çdo shpresë më ty e varr, o Zonjë Hyjlindëse, Nën' e Zotit Krisht, ti më ruaj përherë ti më mpro.

KENDONJESI II: Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve. Amin.

Mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot.

PRIFTI: Paqe të gjithëve.

KORI: Dhe me frymën tënde.

PRIFTI: Krerët tona Zotit le tja unjim.

KORI: Ty, o Zot.

DHJAKU: Le t'i lutemi Zotit.

PRIFTI: O Kryezot mëshirëplot, o Zoti ynë Jesu Krisht, o Perëndia ynë, me nërmjetimet e Shën Marisë, Kryezonjës sonë Virgjëreshës dhe Hyjllindëses; me fuqinë e Kryqit të çëmuar dhe jetëbërës; me lutjet e Shën Joan Pagëzorit, Profetit edhe Parërendësit; të Apostujve të Shentjës, të lavdëruar dhe emërshkëlqyer; të Dëshmorëve të Shenjtë dhe bukurmundës; të Atërve tanë Oshënarë dhe hyjprurës; të Shën Joakimit edhe të Shën Annës, Hyjprindërve të drejtë, pritnaje lutjen me mirësi; dhurona ndjesën e mëkatave; mbulona nënë hien e fletëve të tua; largonaji armiqtë dhe kundërshhtarët; paqësonaje jetën. O Zot, kij mëshirë për ne dhe për botën tënde, dhe shpëtoji shpirtet tona si i mirë dhe njeridashës.

*Pastaj Prifti këndon Litantinë pasonjëse pa qëndruar dhe Vallet pa prerë përgjigjen: "Mëshiro, o Zot."*

Le të lutemi për paqen e botës.

Për të Krishterët besëmirë dhe Orthodoxë.

Për Kryepeshkopin tonë (**aksh**) dhe për tërë Vëllazërinë tonë më Krishtin.

Për atërit edhe vëllezërit tanë të jetënderuar.

Për ata, që na shërbejnë, dhe për ata, që na kanë shërbyer.

Për ata, që na urrejnë, dhe për ata, që na duan.

Për ata, që na porrosinë ne të pavyerit të lutemi për ta.

Për çlirimin e robërve.

Për mirëlundrëzonjësit e deteve.

Për të dergjurit në sëmundje.

Për plotësinë e pemëve të dheut.

Për të gjithë të Krishterët Orthodoxë, që prehen këtu dhe kudo.

Le të thomi edhe për veten tonë: Mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot; mëshiro, o Zot.

*Pastaj të gjithë përshëndoshin dorën e Prellatit. Në këtë mes, Vallja këndon të Hënave dhe të Mërkurave këtë Hyjllindësore në Tingëllin Tërthor II:*

### PAS OLIN APOTHEMENI

Mos më neverit tani, nënë kujdesin e botës, Zonjë dhe Hyjllindëse, eja prit-e lutjen e shërbëtorit tënt; se më kapi helm' i keq, dhe nuk i duronj dot më, shigjetimet e demonëve, strehë gjëkund i s' gjenj, as ku të përikënj i varfëri; luftë kam me çdo armik, tjetër ngushëllim përveç teje s' kam. Zonj' e tërë botës, ti mprojtje je për çdo besnik, mos m'i përbuz pra të luturat, nem mëshirë dhe shpëtim.

*Të Martave dhe të Enjtave mbrëmëne, Vallja këndon këtë Hyjllindësore në Tingëllin I:*

### SFAJIN SU TIN ADHIKON

Të therur si shqerr' o Zoti Krisht, Virgjëresha kur të pa, po të thërriste me vaj e lot. O i përmallshim Bir, si pa faj të varrnë, të mbërthyen përmi Kryq, që dhen' e varre mi ujërat. Mos vdis dhe mos më lër, mua Nënë vetëm dhe në zi, të shkretuar, o Zot i mëshirave.

*SHENIM: Javën e parë, pas Doksollogjisë, këndohet Kanuni i Math, edhe pas Këngës VI këndohet ngadalë:*

## SHKURTORJA, T.T.II.

## PSIKHI MU PSIKHI MU

O shpirt i dremitur, o shpirt mos fli po zgjohu, se vdekja afrohet, dhe keq do të dënohesh. Po ngrehu me vrap edhe lyp-i ndjesë Jesujt Perëndi, që ndodhet kudo dhe i mbush të gjitha.